




REPUBLIKA E KOSOVËS
REPUBLIC OF KOSOVO / REPUBLIKA KOSOVA
KOMUNA E SHITES
MUNICIPALITY OF SHITE/ OPSTINA STIMLJE
ZYRA E KRYETARIT TË KOMUNËS
/KANCELARIJA PRESEDNIKA OPSTINE/MAYOR'S OFFICE



ZYRA PËR INFORMIM/ INFORMATION OFFICE/ KANCELARIJA ZA INFORMISANJE

Procesverbal nga Dëgjimi Buxhetor me Organizata, Klube sportive dhe Biznese, mbajtur më 12 shtator 2024, në ora 18:00, në sallën e Kuvendit të Komunës së Shtimes

Në mbledhje kanë marrë pjesë: Kryetari i Komunës së Shtimes, Qemajl Aliu, drejtorë komunal, zyrtarë komunal, përfaqësues të organizatave, përfaqësues të klubeve sportive dhe bizneseve si dhe qytetarë.

Kryetari merr fjalën dhe jep sqarime rreth Dëgjimit Buxhetor.

Qemajl Aliu: Në kuadër të hartimit dhe ndërtimit të buxhetit komunal për vitin 2024/2025, sot ky dëgjim publik është thirrur për klubet sportive, organizatat dhe për bizneset. Normalisht ne si komunë kemi shumë sportistë, shumë klube, shumë kompani, biznese dhe organizata megjithatë ftesa ka qenë publike e hapur kush do që ka mundur ka patur mundësin me qenë këtu.

Dëgjimet publike tregojnë qytetari active, tregojnë vëmendje, tregojnë kontribut qytetarë, megjithatë ju falenderoj secilin prej juve që jeni sot këtu, që buxhetin e Komunës së Shtimes, taksat e Komunës së Shtimes, shërndarjen e taksave të Komunes së shtimes me bë më transparente, më legjitime, më të barabartë. Po mundohem me dhënë spjegime së bashku me drejtorin për financa dhe buxhet, zotin Besnik Ahmeti por edhe me drejtorët e fushave të tjera, ndërkohë që mund të hapim edhe debatin dhe mund të flasim.

Buxheti i Komunës së Shtimes për vitin 2025 është 10.7 milion euro, është një nga buxhetet më të mëdha që ka pas Komuna e Shtimes, në buxhetin lokal ose thënë në shifrat 870 mijë euro më shumë se sa viti paraprak. Megjithatë ne e dim që nevojat që ka Komuna e Shtimes ky buxhet komunal është modest dhe normal i pamjaftueshem dhe nëse nuk do të ishin burimet tjera financiare që vijnë nga ministritë e linjes dhe organizatat e tjera buxhetore dmth ky buxhet nuk do të ishte zhvillimor, mirpo falë angazhimit tonë dhe falë dashamirsisë së ministrive dhe qeverisë, ne mund të ju themi hapur që po kaq para për secilin vit buxhetor po vijnë dhe po investohen në sferat e

ndryshme në Komunë të Shtimes, për këtë jemi dëshmitarë gjithësecili prej nesh sidomos qytetarët aktiv sikur puna e juaj që dmth që jepni kontributin në vazhdimësi.

Prej këtyre 10.7 milion euro, diku 56 përqind ose 5.9 milion euro, shkojnë për paga dhe medijtje. Ne e dim që Komuna e Shtimes, ka rreth 712 puntorë që e mbulojnë arsimin parashkollorë, fillor dhe të mesme, pastaj është shëndetësia, administrata dhe shërbimet publike, ku në total e bartin 56 përqind të buxhetit të Komunës së Shtime. Shpenzimet komunale janë 230 mijë euro, kategoria e subvencioneve dhe transfereve është 500 mijë euro si dhe shërbimeve kapitale 2.5 milion euro si dhe digasteri i mallrave dhe shërbimeve është 1.5 milion euro, nëse e analizojmë e shohim që në fund pagat dhe medijtjet janë para që shkojnë te pagat e punëtorëve dhe nuk është fare buxhet zhvillimor dhe mbetet dikund më pak se 4 milion euro që mbetet për investimet kapitale, për mallra dhe shërbime dhe për subvencione si dhe për këto që quhen shpenzime të kuvendit komunal.

Ky dëgjim publik e ka fokus grupin e bizneseve, organizatave dhe shoqatave sportive, unë mund të ju them për subvencione dhe transfere. i kemi gjetë diku nën 300 mijë euro kur e kemi marrë mandatin për të qeverisur Komunën e Shtimes, vitin e fundit kemi shkuar 350 mijë euro dhe këtë vit e kemi rritur në 500 mijë euro.

Ministria e financave dhe ligji i menaxhimit të financave publike nuk lejon me pas shpërputhje, nuk lejon me pas më shumë se sa 5 përqind të buxhetit në digasterin e subvencioneve, përndryshe duke pasur parasysh subvencionet ndahen në arsim, në shëndetësi, në sport, në kulturë, në rini, në bujqësi dmth ne realisht kemi nevojë jo 500 mijë por për 3 milion euro, mirpo ligji menaxhimit për financa publike nuk e lejon, ne e kemi kapur limitin e lejuar të kësaj kategorie të financave.

Komuna e Shtimes, ka 23 fshatra përveq qytetit, 18 fshatra janë të banuara aktualisht dhe janë 5 fshatra te braktisura, ne po mundohemi që këto 2.5 milionë euro me i nda në mënyrë të barabartë që të ketë zhvillim në mënyrë homogjene, fatmirsisht kemi pas mundësi me zhvillu projekte me fonde të tjera përveq këtij buxheti.

Nazmi Iballi: Në këtë kuptimin e ndarjes buxhetore nuk keni lënë hapsirë për me diskutu sepse ju keni shfrytëzu dispoziten e ligjit për financa publike që lejon maksimumin, përkatsisht 5 përqind të buxhetit për ndarjen proporcionale përkatisht ndarja sipas kategorive buxhetore. Një e di që në fund të gjithë dalin të pa knaqur në kuptim të asaj të mbulimit të asaj se sa janë për klube, sa janë për

shoqata. Ka pas një gatishmëri të jashtëzakonshme të rinisë shtimjane për me u organizu me themelu nje klub të basketbollit që Shtimja nuk e ka pas. Kërkesa tjetër është që do te mbetet zbraztirë për mbulimet e kërkesave të klubeve dhe shoqatave për realizimin e dëshirave. Rinia jonë duhet me pas hapsirën megjithëse në kuptim të infrastrukturës jeni

për tu komplimentu, sinqerisht po e tham sa kam unë informata nga klubet sportive, faleminderit shumë.

Qemajl Aliu: Profesor faleminderit për kontributin që po e jep bashkë me shumë qytetarë që janë prezentë këtu. Për klubin e basketbollit vertetë ne e dim dhe e njohim këtë. Basketbolli është një nga 3,4 sportet më të popullarizuara në komunën tonë, duke pasur talent dhe dashamirë të këtij sporti. Si kryetar mundem me ju garantu me ekipen qeverisen për ndarjen buxhetore për themelimin e klubit dhe do të jeni të mbeshtetur nga fondet locale të cilat ndoshta nuk do të jenë të mjaftueshme por duhet angazhim I përbashkët edhe ju si ish-sportist dhe dashamirë të sportit por edhe ne si qeverisje lokale me gjetë sa më shumë mbështetje, sidomos në raport me bizneset. Ne skemi me hezitu për me ju kerku në këtë rast për rinin e Shtimes, për sportistet e Shtimes.

Sa u përket borgjeve, e patë që jo më shumë se 4 milion euro, përveq pagave dhe meditjeve që janë të destinuara dhe që nuk kanë të bëjnë me buxhet zhvillimor, është viti i tretë që për çdo vit po paguajmë më shume se 1 milion euro borgje që e kemi të trashëguar e kryesisht vijnë prej kontratës kolektive, prej përmbaruesve prej vendimeve që kanë marr asambllet për vendimet e shpronsimit të pronave po edhe për ankesat që vijnë nga dëmtimi i parcelave.

Një përlllogaritje që kemi bo me bashkpuntorët tonë, janë diku rreth 7 milion euro vetem prej kontratës kolektive dhe prej shpronsimeve që shumicën e rasteve fare nuk kanë qenë në interes të përgjithshëm të komunës por më shumë janë bërë në aspektin klientelist. E dini që edhe shpronsimi i pronave të KRU Prishtinës mes Shtimes dhe Davidovcit janë të uzurpune 5 hektarë tokë për më shume se 22 vite që me çmimin e tregut kap shifren 15 deri 22 milion euro, momentin që janë bartë kompetencat nga niveli lokal në KRU Prishtina normal të gjitha edhe borgjet edhe asetet i shkojnë KRU Prishtina, po qeverisja e kaluar për efekt më shumë populist edhe elektorale ka marr një vendim të çuditshëm në vitin 2010 që e ka marr përsiper vet me i shpronsu ato edhe pse ka pas vite që këto asete janë bartë KRU Prishtinës dhe tash pronarët e atyre pronave, po na padisin neve si komunë dhe në qoftë se edhe kjo ndodhë neve na faturohet një borgj që kap shifren 25 deri në 30 milion euro, nëse me këtë buxhet që kemi neve na detyrohet të paguajm 30 milion euro, unë them si bashkëqytetar i juaji sinqerisht komuna është e falimentuar sepse duhet 8 vite mos me shpenzu asnjë cent për me i la këto borgje, por unë këtë shqetësim e kam ngrit edhe tek instancat e larta shtetërore përkatsisht në ministrin e ekonomise.

Sa i përket investimeve në infrastrukturë, faleminderit për vlerësimin, ne kemi trokitur në çdo derë të minsitrisë, në stadiumin e futbollit është investu rreth 250 mije euro bashkë me FFK.

E kemi një marrëveshje edhe stadiumin e dytë që presim me fillu me ndërtu si stadium mbështetes, është projekti 2.4 milion euro që financohet nga Minsitria e Kultures, Rinis dhe Sportit, që do të bëjmë një stadium të ndenjë për futbollin në komunën tonë.

Salla sportive që po investohet diku rreth gjysëm millioni euro, që do ta kompletojë dhe do të jetë plotësishtë funksionale. Po investohet në qendren e rinis që është objekt i rëndësishëm për rinin dhe klubet sportive që do të kenë edhe zyret atje, po punohet që do të shkojë një investim rreth 1 milion euro, këtë vit presim me marr mbështetje nga ministria edhe për një projekt për trajtimin komplet të asaj që quhet kodra te kisha që do të bëhen kënde lojrash, terene sportive edhe shërbime tjera. Do të i nënshtrohen renovimit të gjitha stadiumet e vogla që janë në fshatra dhe do të ndërtohen të reja aty ku nuk ka, besoj që në këtë aspekt qendrojmë mirë përveq këtyre problematikave që i thamë.

Shefki Dauti: Faleminderit kryetar! Përshendetje për të gjithë, po besoj që u trajtu pak a shumë edhe çështja e investimeve, është për tu falenderuar nga Klubi Futbollistik Vjosa për investimet që po bëhen në stadiumin e qytetit, ecuria e punes po ecë jashtëzakonishtë mirë me dinamikë, po besoj që mbrenda 6 muj ose 1 vjet përfundon e gjitha, e rëndësishme është që stadiumi i qytetit të Shtimes është model që i plotëson të gjitha kriteret e nevojshme dhe kjo është për me u falenderu.

I specifikove kur the prej 350 mijë bëhet në 500 mijë subvencione, në këtë rast kemi 150 mijë euro rritje të subvencioneve, unë si propozim kisha thanë që 50 përqind e kësaj rritje të shkoj në sport në përgjëthsi, duhet pasur parasysh Kryetar sikur jeta që është rritur sikur shpenzimet, mirëmbajtja, pagesat e lojtarëve po thuajse mbrenda 2 viteve mbi 100 përqind dhe kjo e ka vështirsu edhe funksionimin e klubeve që janë në komunën tonë dhe gjithë Kosovën.

Kisha kërku nga ti si kryetar që trysnia në biznese të jetë një urë lidhse mes klubeve dhe bizneseve sepse është shumë e nevojshme, ne e dim që hatri i bizneseve në kryetarin është më i madh se sa me ne klubet e futbollit, kemi nevoj për mbështetje, faleminderit.

Qemajl Aliu: Klubi Sportiv Vjosa sidomos këto vitet e fundit po na bënë krenar dmth një qytet i vogël por shumë afer mundësisë me kalu në eliten e superliges së futbollit, kështu që kjo është për tu admiruar. Po ashtu futsall dhe henbolli i djemëve ka arritur me shku në superligë, poashtu edhe vajzat por edhe sportet individuale janë duke korrur suksese neve na vjen keq që sinqerisht me shumë nuk mund të bëjm sepse ne e kemi rrit maksimum në sektorin për subvencionim.

Djemtë dhe vajzat dhe sportistët e Komunës së Shtimes nuk janë as të Qemajl Aliut e as të Shefki Dauti ata janë familjarë të bashkëvendasëve tanë, janë vëllezerit dhe motrat tona, brezat që sjellin trofë, suksese në sport, që sjellin krenari, sjellin shëndet, ato janë

vlera që meriton secili me bo diçka në këtë aspekt. Ne nuk do të heqim dorë dhe do të mundohemi të ju kujtojmë herë pas here.

Disa prej përfaqësuesve të bizneseve që janë këtu, singërisht që prej dites së parë ja kam shtri dorën e bashkëpunimit kundrejt asnjë interesi, thjesht si kryeshërbëtor i Komunes së Shtimes. Ne bizneset i shohim si aset të zhvillimit ekonomik të Komunës së Shtimes, dmth biznesi është pararojë e zhvillimit është e dyta për zhvillimin e komunes, si të tillë ne duhet me i trajtu dhe përkrahë. Deri tani ky komunikim nuk ka qenë në nivelin e duhur, me këtë rast ju bëj thirrje që zyren e kryetarit, zyren e drejtorave munden ata me frekuentu për çfardo kërkesë që kanë pa hezituat sepse ne nuk kemi asnjë rezeverë, sepse ne i shohim si aset të zhvillimit të qytetit tonë.

Kemi mendu për këta operatorët që dëmtojnë natyrën edhe infrastrukturen, me i taksu, janë mbi 10 operator që operojnë në Komunën e Shtimes, që shumica prej tyre nuk janë të Komunës së Shtimes por shumica prej tyre janë sponsor të shume klubeve sportive jashtë Shtimes. Nuk na pengon kjo sepse është vullneti i tyre, megjithatë kur ata marrin përsiper me sponzorizim klubin e Ferizajit ndërsa krejt burimet janë të ardhura nga Komuna e Shtimes është mirë me pas një mirnjohje për Komunën e Shtimes, megjithëse do të flas me ta në mënyrë të veçantë. Ne jemi mundu përmes rregullores që e kemi kalu në kuvendin e Komunes së Shtimes me caktu çdo vit nga një taksë prej 1 mijë deri në 20 mijë varësisht prej gjiros që e bëjnë, kjo është një kërkesë minimale meqenëse vullnetarisht po shihet që po hezitojnë, dhe gjithë këto të hyra, unë nuk do i dërgoj në asnjë vend tjetër, krejt këto të hyra do ti shpërndaj sportit, rinisë dhe kulturës, të shohim se sa do të arrijmë me inkasë.

Besnik Ahmeti: Taksa është me rregullore për gjambat nga 1 mijë deri në 20 mijë për gjithë këta gurëthyes që operojnë në komunën tonë, siç e tha edhe kryetari shumica prej tyre nuk janë të komunës tonë dhe sponzorizojnë klube në qytete të ndryshme, ne presim minimum me qenë 100 mijë euro inkasim i të hyrave.

Qemajl Aliu: Unë zotohem publikisht para juve, që drejtori i financave prej sot e ka për detyrë dmth me i nda se ato të hyrat që vijnë prej shumë sektoreve po këto të hyra që vijnë prej operatorëve janë të dedikume vetëm për sport rini dhe kulturë, dmth do të ndahet vetëm për këto 3 dikastere dhe asnjë qindarkë tjetër nuk do të shkojë në sektoret e tjerë.

Shefki Dauti: Mendoj që ka pasur mungesë të informimit për bizneset dhe klubet sportive dhe mendoj që ka qenë e rëndësishme me qenë numri më i madh i pjesëmarrësve për diskutimin e kësaj qështjeje.

Albana Fazliu: Ne i kemi ftuar të gjithë, disa prej klubeve që janë më aktive nuk janë përgjigjë ftesës as tash as herave tjera.

Bekim Shahini: Unë kam një pyetje për drejtoreshën për Kulturë, Rini dhe Sport mbi procesin e renovimit të salles së sportit, qysh kan me shku procedurat për me bo një zgjidhje.

Albana Fazliu: Kemi qenë të informuar, kontrata zgjatë diku rreth 1 vit e gjysëm për renovimin e palestrës, unë kam kërku prej ministrisë së kulturës që pjesa e mbrendshme e sallës të rregullohet sa më shpejt për shkak më ju leju juve që me i kry aktivitetet e juaja dhe ju kam informu personalisht që kam kërku ndriçimin dhe pjesa e parketit të rregullohet, ju prap keni kërku që të shtyhet kjo kerkesë për shkak që jeni në fillimin e sezonit vjeshtor, kam kërkuar nga ju që ushtrimet, stërvitjet të i bëni në shkollat, kam kërku nga ju që kërkesat ti bëni në drejtori të arsimit për shkak mos me ju pengu edhe atyre aty që punojnë.

Qemajl Aliu: Drejtorja përkatëse është mundu më menaxhu këtë situatë, ne duhet me mirëkuptu se aty po bëhet një ndërhyrje dhe me qenë më mirëkuptues për me gjete mundësi me tejkalu këtë situatë që ajo të finalizohet plotësisht. Realisht investitor është ministria e kultures dhe menagjeri i kontratës në këtë rastë është prej ministrisë edhe ne mund ti kërkojmë me mirëkuptim ministrit me një mënyrë të bëjm një presion pozitiv megjithatë dmth duke qenë sponsor ministria dhe duke qenë menagjer i kontrates nga ministria ne nuk është se mund të menagjojmë ashtu qysh mundemi të menagjojmë fonde qe financojmë si qeverisje komunale.

Siç e tha edhe drejtoresha vërtet puna ka filluar nga lartë poshtë sepse realisht ne po futemi në vjeshtë dhe kushtet meteorologjike janë të tilla që së pari të rregullohet pika kulmi që mos me rrjedhë e pastaj zbresim te poshtë. Për një lojë dy ose tri lojë ne mund të kërkojmë ndihmë tek komunat fqinje, për një muaj, unë kerkoj mirkuptimin prej qyteteve fqinje siç është Ferizaj, Suharekë ,Lipjan të gjejmë një zgjidhje.

Shaban Rexhaj: Për qfarë është zvarritë salla e sportit në fshatin Petrovë, kur pritet që të përfundohet salla.

Qemajl Aliu: Jam i informuar shumë mirë për këtë, shkolla “Bajram Curri”, ju e keni parë që e kemi buxhetuar për ta rindërtu pjesërisht dhe për tu renovuar ajo pjesa më e re, dmth janë 1 milion 450 mijë euro që janë në fazen e përzgjedhjes së operatorit të tenderimit, poashtu pjesë e këtij trajtimi ka me qene edhe salla e sportit jo vetme në shkollën “Bajram Curri”, por edhe në fshatin e shkollës së Carralevës, Muzeqinës edhe të Pjetërshticës, janë salla që janë nis nga viti 2016 edhe në dokumente që kemi gjetur 4 a 5 herë në ato shkolla ka dal komisioni i pranimit dhe i ka pranu ashtu si janë dhe ka gjetë diferencë nëse ka pas mu investu 500 mijë euro, komisioni ka pranu që janë investu vetem 400 mijë euro dhe ja kanë shkëput kontratën operatorit dhe kanë thënë që duhet me u ritenderu për 100 mije tjera, kur e kan ritenderu për 100 mijë tjera nuk kanë mjaftu 100 mijë dmth e kanë pa që duhet me u investu 200 mijë, kjo i përket të kalumes edhe për

shkollën e Carralevës kemi gjetë shkelje të auditorit që saher ka pas komision pranimi dhe ritenderimi diku rreth 20 deri 30 mijë euro ka lëvizje edhe i bjen që saher është pranuar dëmet e taksave tona qoftë qendrore, qoftë lokale kanë bërë ka 20-30 mijë euro. Ka ndodhur me sallat sportive, shkollën e Carralevës dhe shkollën e fshatit Muzeqinë. Gjithashtu në shkollën e Muzeqinës është dashtë me u investu edhe 100 mijë euro për me bërë funksionale, kjo është qështje e prokurorisë, ka qene katrahurë e madhe.

Ne me këtë fondin 1 milion e 450 mijë euro kemi me rrënu objektin e vjetër dhe kemi me rikonstruktuar komplet edhe aneksin e ri edhe të vjetrin edhe kemi me bërë sallën sportive funksionale plotësisht, ky është fondi për dy vitet e ardhëshme.

Sa i takon fshatit Petrovë, është fshati më i madh në Komunën e Shtimës dhe si të tillë ne jo veq që jemi zotë por që e kemi fatin me implementu zotimet edhe këtë vit edhe vitin e ardhshëm në fshatin Petrovë kanë me u investu mbi 5 milion euro, 1.5 milion euro është shkolla, mbi 600 mijë euro qerdhja që edhe ajo është në përzgjedhje të operatorit, është rruga Mehdi Korani bashkë me urën që e kalon gjysmë milioni euro edhe është rruga që vjen prej pishave ku është rreth rrotullimi i Belincit, për krejt këta operator që i dëmtojnë rrugët e fshatit Petrovë, Reçak por edhe disa fshatra të Komunës së Shtimes, do të bëhet një zgjidhje e përhershme përmes asaj mase 2.5 milion euro, të gjithë këto janë të buxhetume.

Faton Imeri: Jam përfaqësues i klubit hendbollistik Vjosa femrat, gjithashtu përfaqësoj edhe shoqëritë peshkatore që jam njëri ndër të parët. Kam një propozim për krijimin e një qendre sportive recreative në shkollën e fshatit Llanisht, kam kontaktuar me ambasaden Norvegjeze dmth për një investim të ambasades norvegjeze që të kemi një investim për një qender rekreative sportive ku do të jetë një fushë e mbyllur e hendbollit, basketbollit dhe sporteve tjera, si ide e kam pas dhe një shteg për ecje për gjitha moshat, e kemi llogarit diku 8 milion me qenë investime. Dhe në palestren sportive shumë pa pastërti.

Qemajl Aliu: Këta që the ti për papastërtin në palestren sportive shumë mirë që e ke thanë, se unë kur e kam thënë në fushatë më kanë gozhdur.

Në gjithë e dim se është relievi përveq atij fushor edhe malor vërtet fshatrat e malësisë i kemi me një religjion të jashtëzakonshëm edhe duke patur këtë vetëdije ne po mundohemi si qeverisje komunale me dërgu infrastrukturën atje. Është detyrë e qeverisë lokale pastaj kur të jetë rruga edhe pjesët tjera infrastrukturore pastaj vijnë edhe investimet që kanë ndodhur si në fshatin Jezec në kuader të investimeve që po bëjmë është se para disa ditësh kam nënshkruar një projekt shumë të mirë, shënimi i shtigjeve të ecjes në të gjitha fshatrat malore për të aposianuarit të ecjes do të bëhet përmes një projekti 50 mijë eurosh. Sot kam pas një takim me ministrin e kultures Hajrullah Çekun dhe këtë vit ai po e pregaditë një paketë për ngritjen e fshatrave turistike në Kosovë, kemi arritë 3 deri në 4 fshatra të Shtimes me e gëzuar këtë status, statusin e të qenurit fshat turistik që ka

me u investu prej ministrisë së kultures që janë fonde dhjetra milionëshe edhe normal që ne propozimet i kemi bo për fshatin Reqak dmth na e dijmë rëndesin e fshatit Reqak, por edhe fshatin Llanisht dhe fshatin Devetak që aty është edhe shpella që është shfrytëzu nga profesoret dhe mjektë e UÇK-së dmth është simbol atje i mbrojtjes dhe i shërbimit të krejt të plagosurve të luftës, natyra është fantastike. Shumë shpejt fillon puna prej Petroves deri në Rancë që ka me qenë një segment i zhvillimit të bizneseve dhe besoj javën tjetër e kemi nënshkru kontraten për rrugën Pjetërshticë, Dugë.


Rruga e Duges ju e dini që graviton tashmë në territorin e Suharekes dhe është e pa përshtatshme. Ne shkojmë me infrastrukturë pastaj investimet private të bizneseve vijnë mbrapa dhe besoj që me këto investime infrastrukturore me kapacitetet e bizneseve me investu atje. Model është fshati Jezerc, po edhe këto 3, 4 fshatra me i fut dmth në këtë listën që e gëzojnë statusin e fshatrave turistike të investune me dhjetra miliona nga minsitria e kultures dhe qeveria besoj qe kemi me i dhënë edhe një zhvillim edhe atyre që i përmendem, po edhe shkolla e Llanishtit që mu edhe shumë biznese mëkanë pytur. Unë mendoj që aty mundet me u bo një qender rekreative sportive e jashtëzakonshme për të rinjët dhe të rejat për gjithë qytetaret e Komunës së Shtimes.

Grejtalb Emini: Përshendetje për të gjithë, ka mbet në gjysmë një trotuar deri tek palestra dhe besoj këtë vit e përfundojmë. Është një ndriqim publik nga qendra e Shtimes deri në fshatin Mollopolc dhe synimet tona janë që mu ba një shteg i ecjes deri në fshatin Mollopolc për shkak se është zonë e mirë për ecje, edhe parkingu i palestres do të ketë ndriqim. Rruga e Llanishtit dmth rruga Petrovë – Llanisht përkatësisht është shume e ngushtë, kryetari sot ka bërë një kërkesë në ministri besojmë që një pjese e asaj rruge të zgjerohet dhe do të shkon rruga prej mullinit të Llanishtit deri në Devetak, e dimë që lidhet prej Devetakut deri në Jezerc. E dim që është një arterie e rëndesishme për të zhvillimin e turizmit.

Qemajl Aliu Nëse edhe dikush dëshiron fjalën ne jemi këtu, nëse nuk kemi asgjë, neve ju falenderojmë për pjesëmarrjen dhe ta keni me dije që ne do të jemi gjithëmonë mbështetja juaj më e madhe kurdo që keni nevojë dhe do të mundohemi vazhdimisht sikur deri tani që ti rrisim fondet gjithmonë në mbështetje të juajin

S'na mbete gjë tjetër veqse t'a mbyllim këtë takim dhe t'ju falenderoj sinqerisht edhe njëherë për prezencën dhe kohën që keni ndarë për të qenë në këtë dëgjim publik dhe ju inkurojoj që çdo dëgjim publik që organizon komuna t'i përgjigjeni.











Dëgjimi buxhetor ka përfunduar në ora 20:00








Procesmbajtës:
Vlora Hyseni

**LISTA E PJESËMARRËSVE NË DËGJIMIN BUXHETOR ME ORGANIZATA, KLUBE SPORTIVE DHE
BIZNESET**

Shtime, më 12 shtator 2024 (e enjte)

Nr.	Emri dhe mbiemri	Institucioni	Nënshkrimi
1	Memtor Kadriu	FC. SHTIMJA-26	
2	BERGIM SHAHINI	VJOSA FURSAL	
3	SHEFKI DAUTI	KF. VJOSA	
4	SHARAX F. REXHAS	KALAJA-EPOX	
5	NAZMI IBALLI		
6	FATON IMENI	KHF VJOSA	
7	SHAQIR SHAQIRI	KHF VJOSA	
8	Muhamet Berigi	OGJ D+	
9	GRETTACB EMIHI	DREJTOR	
10	BESVIR AHMETI	DREJTOR	
11	Albana Fazliu	Drejtoreshe	
12	Fenide Rexhej	shtime	
13	Bordyl Rustiti	Drejtore	
14	SANTJE SADIKU	BONUMIA	
15	Nebil Maksuti	K.shtime	
16	Adem Camadani	K.shtime	
17	Gazmend Aliu	K.shtime	

Nr.	Emri dhe mbiemri	Institucioni	Nënshkrimi
18	Anita Kurti	K.S.H	
19	Agim Hysenaj	SHITE	
20	Vlora Hyseni	Komuna Shite	
21	LULZIM KANETI	K.H "VJOSA"	
22	DRITEN LATIFI	SPORTIST	
23	Albion Shabani	Shite	ASE:
24			
25			
26			
27			
28			
29			
30			
31			
32			
33			
34			
35			
36			
37			
38			

